

URDHËR
Nr.222, datë 1.4.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.132, DATË 8.3.2020 “PËR MBYLLJEN
E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ANULLIMIN E
GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “a”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1 dhe 2 të urdhrin nr.132, datë 8.3.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, togfjalëshi “deri në datën 3 prill 2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**